



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 23 tetor 2024
Nr. ref.: AGJ 2570/24

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI43/24

Parashtrues

Merita Visoka, Eroll Visoka, dhe Melinde Visoka

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Rev. nr. 382/2023 të 17 tetorit
2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Merita Visoka, Eroll Visoka, dhe Melinde Visoka, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës), të përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" Sh.P.K., në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Rev. nr. 382/2023] të 17 tetorit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 737/19] të 17 korrikut 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit), dhe Aktgjykimin [C.nr.106/2013] të 8 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Podujevë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesit e kërkesës Vendimin e kontestuar e kanë pranuar më 31 tetor 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. nr. 382/2023] të 17 tetorit 2023 të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkëlur të drejtat dhe liritë themelore të tyre të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 20 shkurt 2024, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 21 shkurt 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI71/24] caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu Krasniqi, gjyqtare raportuese ndërsa përmes Vendimit [nr. KSH. KI71/24] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 19 mars 2024, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 24 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri votash i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
11. Në të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, vendosi që (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se Aktvendimi [Rev. nr. 382/2023] i 17 tetorit 2023 i Gjykatës Supreme, nuk është në përputhje me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhje e fakteve

12. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se procedura gjyqësore filloi më 11 mars 2013, kur Eroll Visoka (njëri prej parashtruesve të kërkesës) paditi Komunën e Podujevës. Në kërkesëpadi, i njëjti ka kërkuar të vërtetohet se është pronari paluajtshmërisë nr. 552 në "Qytet-rruga Zahir Pajaziti", me kulturë shtëpi (00.0045 ha), oborr (00.05.00 ha) dhe arë (00.00.58 ha). Po ashtu, për ngastrën kadastrale nr. 553 në "Qytet-Trualli", me kulturë arë (00.05.60 ha), të gjitha të regjistruara në fletën poseduese 1230 HA, ZK Podujevë. Këto prona u eksproprijuan përmes Aktvendimit të eksproprijimit [nr. 04-466-765/3] të 28 korrikut 1980, i cili u bë i ekzekutueshëm më 5 nëntor 1980 nga të paditurit për ndërtimin e shtëpisë së kulturës dhe rrjedhimisht ato u regjistruan si pronë shoqërore në emër të Komunës së Podujevës. Në kërkesëpadi, ai nuk ka saktësuar vlerën e kontestit në fjalë.
13. Më 13 qershor 2013, Eroll Visoka precizoi padinë përmes parashtrësës duke zgjeruar padinë me parashtruesit e tjerë të kërkesës, por sërish as në kërkesëpadinë e saktësuar, parashtruesit e kërkesës nuk e kanë saktësuar vlerën e kontestit në fjalë.
14. Më 8 nëntor 2018, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin [C.nr.106/2013], refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës. Gjykata Themelore, pas vlerësimit të provave dhe dëshmimeve, konstatoi se eksproprijimi është kryer në përputhje me ligjin dhe paraardhësit e parashtruesve të kërkesës kanë marrë kompensim, edhe pse jo adekuat sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës. Po ashtu, Gjykata Themelore theksoi se parashtruesit e kërkesës kanë humbur afatin ligjor për kërkesën për kthimin e pronësisë, duke mos vepruar në përputhje me afatet e Ligjit mbi Eksproprijimin dhe Ligjit të Punës së Bashkuar.
15. Kundër këtij Aktgjykimi, parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, aplikimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të gjendjes materiale.
16. Më 17 korrik 2023, Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas ankesës, mori Aktgjykimin [Ac.nr.737/19], me të cilin refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve të kërkesës, ndërsa vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.106/2023] e Gjykatës Themelore. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit theksoi se nuk ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë obligohet sipas detyrës zyrtare t'i ekzaminojë ato, dhe nuk ka gjetur se aktgjykimi në fjalë është i pakuptimtë dhe kontradiktor ndër vetë. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës, Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe se mbi bazën e kësaj, ka zbatuar drejtë edhe të drejtën materiale.
17. Më 4 shtator 2023, ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, i autorizuari i parashtruesve të kërkesës paraqiti revizion pranë Gjykatës Supreme me propozim që Gjykata Supreme të aprovojë në tërësi revizionin, duke anuluar Aktgjykimin [Ac.nr.737/2019] të 17 korrikut 2023 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C.nr.106/13] të 8 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore, dhe që çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
18. Më 17 tetor 2023, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin [Rev.nr. 382/2023] me të cilin hodhi poshtë si të palejuar revizionin e përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës, të paraqitur kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 737/19] të Gjykatës së Apelit të 17 korrikut 2023.
19. Në arsyetimin e saj, Gjykata Supreme theksoi se në këtë çështje juridike kontestimore fillimisht vlerësoi lejueshmërinë e revizionit bazuar në paragrafin 3 të nenit 211 të Ligjit

për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), ku është përcaktuar: *"Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesa në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë obligimi tjetër, nëse vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk kalon shumë prej 3.000 €"*.

20. Më tej, Gjykata Supreme theksoi se në nenin 30 paragrafi 1 të LPK-së, përcaktohet se: *"Paditësi ka për detyrë që në kontestet pasurore juridike, në padi të përcaktojë vlerën e objektit të kontestit. Si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore"*, ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet: *"Kamatat, shpenzimet e procedurës, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera aksesore, nuk merren parasysh nëse nuk përbëjnë kërkesë kryesore"*.
21. Tutje, në Aktvendim, Gjykata Supreme arsyetoi se as me padinë fillestare dhe as me precizimin e mëvonshëm të kërkesës nuk është përcaktuar vlera e kontestit. Gjykata Supreme, më tej, theksoi se Gjykata Themelore, me vërejtjen gjyqësore të 9 marsit 2017, ka ftuar parashtruesit e kërkesës që në emër të taksës gjyqësore për padi të paguajë taksën në lartësi prej 15 €, të cilën e kanë paguar parashtruesit e kërkesës. Gjykata Supreme arsyetoi se është e obliguar të vlerësojë lejueshmërinë e revizionit dhe në këtë rast revizioni nuk është i lejuar për shkak të vlerës së kontestit, marrë për bazë faktin që parashtruesit e kërkesës nuk kanë cekur vlerën e kontestit në padi dhe në precizimin e mëvonshëm të kërkesës, ndërsa taksa e paguar për padi nuk e tejkalon vlerën e kontestit mbi 3.000 € sipas udhëzimit administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore. Po ashtu, natyra e kontestit nuk përbën përjashtim për lejueshmërinë e revizionit. Si përfundim, Gjykata Supreme gjeti se, pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218.1 dhe 2 pika d) të LPK-së, që të hedhë revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme, me zbatimin e nenit 221 të LPK-së, duhej që të njëjtin ta hedhë si të palejuar.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

22. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktvendimi [Rev. nr. 382/2023] i 17 tetorit 2023 i Gjykatës Supreme u cenon të drejtat dhe liritë themelore të tyre të përcaktuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së.
23. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se Gjykata Supreme ka theksuar se ata nuk e kanë përcaktuar vlerën e kontestit në padi dhe as më vonë gjatë procedurës, dhe kjo mungesë nuk është eliminuar deri në fund të procesit. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Gjykata Supreme ka lëshuar vërejtjen gjyqësore në emër të padisë, por ka injoruar dispozitat e LPK-së dhe se nuk ka dhënë arsye përse gjykatat e rregullta nuk respektojnë nenin 36 të LPK-së, i cili kërkon që gjykata të përcaktojë vlerën e kontestit kur palët nuk e bëjnë këtë.
24. Më tej, parashtruesit e kërkesës theksojnë se sipas nenit 36 të LPK-së, është përgjegjësi e gjykatës, jo e paditësit, të përcaktojë vlerën e kontestit kur kjo nuk është bërë nga palët. Dhe se në rastin konkret, për shkak të lëshimit të gjykatës për të përcaktuar vlerën, parashtruesit e kërkesës janë privuar nga e drejta për të ushtruar mjete juridike të jashtëzakonshme. Dhe se LPK-ja kërkon që gjykata të veprojë *ex officio* për të përcaktuar vlerën e kontestit bazuar në rrethanat objektive dhe kërkesën e palës, nëse pala paditëse nuk e përcakton vlerën, gjykata duhet ta bëjë këtë në seancën përkatëse ose në seancën e parë të shqyrtimit kryesor. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë se gabimi i gjykatës nuk mund t'i atribuohet paditësit dhe nuk duhet të pengojë të drejtën e tij për mbrojtje efektive juridike. Dhe se sipas ligjit, përgjegjësia për përcaktimin e vlerës së kontestit, kur objekti i kërkesëpadisë nuk ka të bëjë me kërkesa monetare, bie mbi palën paditëse dhe gjykatën, nëse paditësi nuk e përcakton vlerën e

kontestit, kjo nuk duhet të pengojë mbrojtjen efikase gjyqësore. Më tej, parashtruesit e kërkesës theksojnë se ligji parashikon që, në rast se paditësi nuk e përcakton vlerën ose abuzon me këtë të drejtë, gjykata duhet ta caktojë vlerën e kontestit *ex officio* dhe se kjo është detyrë e gjykatës sipas nenit 36 të LPK-së.

25. Parashtruesit e kërkesës shprehin se kjo çështje përqendrohet në dy pyetje kryesore se a ka gjykata obligimin sipas nenit 36 të LPK-së që të përcaktojë vlerën e kontestit kur palët nuk e kanë përcaktuar atë? Dhe se a është e drejtë t'i atribuohet kërkuarit dështimi i gjykatës për të zbatuar ligjin, që po pengon shqyrtimin meritore të revizionit? Dhe se në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka zbatuar saktë LPK-në, duke mos përcaktuar vlerën e kontestit, çka ka pamundësuar paraqitjen e revizionit, i cili kërkon që vlera e kontestit të jetë të paktën 3.000 €. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë se kjo përgjegjësi nuk mund t'i ngarkohet paditësit, i cili nuk kishte mundësi të përcaktonte vlerën në atë fazë dhe se objekt kontesti ishte një pronë e paluajtshme, me vlerë shumë më të lartë se 15 €, sa ishte taksa gjyqësore. Më tej, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Gjykata Supreme, me vendimin për hedhjen poshtë të revizionit si të palejuar, ka vendosur një barrë të padrejtë mbi parashtruesit e kërkesës, duke i mohuar atij të drejtën për akses të plotë në drejtësi dhe për një proces të rregullt ligjor dhe se Gjykata Supreme nuk e ka shqyrtuar revizionin në thelb të tij.
26. Më tej, parashtruesit e kërkesës theksojnë se LPK-ja përcakton se kontestet lidhur me sendet e paluajtshme nuk janë konteste të vlerës së vogël. Dhe se Gjykata Supreme nuk e ka marrë parasysh këtë dispozitë në vlerësimin e kontestit të parashtruesit, i cili përfshinte sende të paluajtshme. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë se nuk i është referuar nenit 36 të LPK-së, që kërkon që gjykata *ex officio* të caktojë vlerën e kontestit kur ajo nuk është përcaktuar nga palët. Më tej, parashtruesit e kërkesës theksojnë se LPK-ja dhe praktika gjyqësore nga Gjykata Supreme e Kroacisë tregojnë se kontestet për paluajtshmëritë janë të përjashtuara nga rregullat për kontestet e vlerës së vogël, po ashtu duke theksuar se neni 486 i LPK-së konfirmon se kontestet me objekt sende të paluajtshme nuk cilësohen si konteste të vlerës së vogël, duke legjitimuar revizionin e parashtruesit për shkak të vlerës së lartë të objektit të kontestit dhe se gjykata është e detyruar të veprojë kur vlera e kontestit nuk është përcaktuar nga palët, sipas nenit 36 të LPK-së.
27. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se Gjykata Supreme, me veprime të kundërligjshme, i ka privuar ata nga mundësia për të pasur qasje në gjykatë dhe nga e drejta që çështja e tij të shqyrtohet në mënyrë të drejtë dhe meritore. Dhe se procedurat gjyqësore duhet të respektojnë parimin kushtetues të sundimit të ligjit, një nga vlerat më të larta të rendit kushtetues të Kosovës. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës shprehin se këto procedura duhet të sigurojnë që pasojat ligjore të jenë në përputhje me pritshmëritë legjitime të palëve në një proces gjyqësor, duke përfshirë edhe pritshmërinë për një zgjidhje meritore të kontestit. Dhe se vlera e kontestit dhe zbatimi i drejtë i dispozitave procedurale nga gjykatat ndikojnë në të drejtat e palëve për të parashtruar revizionin si një mjet të jashtëzakonshëm juridik. Më tej, parashtruesit e kërkesës theksojnë se edhe pse vlera e kontestit mund të jetë përcaktuar, LPK-ja aktuale përcakton se kur kontesti përfshin sende të paluajtshme, vlera e kontestit nuk konsiderohet e vogël.
28. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj), kufizimet nuk duhet të pengojnë ose zvogëlojnë thelbin e të drejtës për të pasur qasje në mjetet juridike dhe se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës synon të sigurojë që palët të dëgjohen dhe të trajtohen në mënyrë të barabartë para gjykatës. Dhe se kjo përfshin jo vetëm të drejtën për të nisur një proces gjyqësor, por edhe për të marrë një vendim përfundimtar nga gjykata, duke kërkuar që qasja të jetë reale dhe jo formale. Më tej, parashtruesit e kërkesës theksojnë se mohimi i kësaj të drejte konsiderohet shkelje e të drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, siç

parashikohet nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së. Dhe se nëse mjete procedural nuk trajtohet në mënyrë substanciale, kjo cenon të drejtën e mbrojtjes dhe qasjen në Gjykatën Supreme. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë se një zbatim i gabuar i normave që çon në mos gjykimin e pretendimeve cenon të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për një proces të rregullt ligjor dhe se të drejtën për parashtrim të revizionit dhe qasjen në gjykatë nuk mund t'ia cenojnë kërkuarit për shkak të mangësive ose gabimeve të organeve shtetërore.

29. Prandaj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që: (i) kërkesën ta konstatojë të pranueshme; (ii) të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të parashtruesve e kërkesës të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së, si rezultat i shkeljeve nga Gjykata Supreme të një mori të drejtash të garantuara për parashtruesit të kërkesës me këto instrumente dhe LPK-në; dhe si pasojë (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme, (iv) të urdhërojë kthimin e rastit në rivendosje; dhe (v) të përcaktojë çfarëdo mase tjetër juridike që Gjykatë e vlerëson si të bazuar juridikisht dhe të arsyeshme.

Dispozitat relevante kushtetuese

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 3

[Barazia para Ligjit]

1. *“Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.*
2. *Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.”*

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*

[...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat*

dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.”

[...]

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

4. Përcaktimi i vlerës së objektit të kontestit

Neni 30

“30.1 Paditësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padi ta përcaktoj vlerën e objektit të kontestit. Si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore“.

Neni 36

“Në qoftë se paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padinë e paraqitur në gjykatë, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka caktuar tepër të lartë apo shumë më të vogël se që është ajo realisht, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësisimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike, por para se të fillojë shqyrtimi i çështjes kryesore, shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktoj, përkatësisht do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi. Në rast të këtillë gjykata vendosë me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankimi”.

REVIZIONI

Neni 211

“Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi”.

LIGJI Nr. 04/L-118 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 11

“Neni 218 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 218

- 1. Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hudhet poshtë me aktvendim të Gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore.*
- 2. Revizioni është i palejueshëm nëse:*

- a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit;
- b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin;
- c) nëse personi i cili ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij;
- d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

- 30. Gjykata, së pari, shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
- 31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...].”

- 32. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tej në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht [...]".

33. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës: i) janë palë e autorizuar, në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës; ii) kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Rev. nr. 382/2023] të 17 tetorit 2023 të Gjykatës Supreme; iii) kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit; iv) kanë specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; si dhe v) kërkesën e kanë dorëzuar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit.
34. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me paragrafin 1 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit 3 të rregullit 34 të Rregullores së punës.
35. Për më tepër, dhe në fund, Gjykata thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

36. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit si dhe pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
37. Në fillim, Gjykata rikujton se thelbi i kontestit gjyqësor pranë gjykatave të rregullta ka të bëjë me parashtruesit e kërkesës, të cilët më 11 mars 2013 paditën Komunën e Podujevës. Parashtruesit e kërkesës kërkuan që t'u njihet ligjërisht pronësia dy parcelave nr. 552 në "Qytet-rruga Zahir Pajaziti" dhe ngastrës kadastrale nr. 553 në "Qytet-Trualli", të gjitha të regjistruara në fletën poseduese 1230 HA, ZK Podujevë. Këto prona, u eksproprijuan nga komuna më 28 korrik 1980 për ndërtimin e një shtëpie kulture. Aktvendimi i eksproprijimit u bë i ekzekutueshëm më 5 nëntor 1980 dhe pronat u regjistruan si pronë shoqërore në emër të Komunës së Podujevës. Gjykata Themelore, me Aktgjykimin [C.nr.106/2013], refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesve, duke konstatuar se eksproprijimi ishte kryer në përputhje me ligjin dhe paraardhësit e paditësve kishin marrë kompensim, edhe pse jo adekuat sipas tyre. Gjykata Themelore gjithashtu theksoi se parashtruesit e kërkesës kanë humbur afatin ligjor për kthimin e pronësisë duke mos vepruar brenda afateve të Ligjit mbi Eksproprijimin dhe Ligjit të Punës së Bashkuar.
38. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit, Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën si të pabazuar. Duke pasur parasysh këtë, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesën për revizion, e cila është refuzuar nga Gjykata Supreme për arsye procedurale, duke arritur në përfundimin se kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës nuk e kalon vlerën prej 3,000 €.
39. Pikërisht fakti se Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtruesve për revizion për arsye tërësisht procedurale i shtyu parashtruesit e kërkesës të paraqisnin kërkesën në Gjykatë, duke pretenduar se ky Aktvendim i Gjykatës Supreme cenon të drejtën e tyre

- për “qasje në gjykatë” të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së. Më konkretisht, Gjykata Supreme, me veprime të kundërligjshme, ka privuar parashtruesit e kërkesës nga mundësia për të pasur qasje në gjykatë dhe nga e drejta që çështja e tij të shqyrtohet në mënyrë të drejtë dhe meritore. Duke theksuar se procedurat gjyqësore duhet të sigurojnë që pasojat ligjore të jenë në përputhje me pritshmëritë legjitime të palëve në një proces gjyqësor dhe se vlera e kontestit mund të jetë përcaktuar, LPK-ja aktuale përcakton se kur kontesti përfshin sende të paluajtshme, vlera e kontestit nuk konsiderohet e vogël.
40. Bazuar në sa më sipër, parashtruesit e kërkesës konkludojnë se revizioni mund të hidhet poshtë vetëm nëse vlera e kontestit nuk e kalon shumën prej 3,000 €, por në rastin konkret shuma e vlerës së kontestit nuk është përcaktuar dhe për këtë arsye i njëjti nuk mund të hidhet poshtë. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsye përse gjykatat e rregullta nuk respektojnë nenin 36 të LPK-së, i cili kërkon që gjykata të përcaktojë vlerën e kontestit kur palët nuk e bëjnë këtë. Dhe se, është e qartë se sipas ligjit, në rast se paditësi nuk ka përcaktuar vlerën e kontestit sipas nenit 30 të LPK-së, atëherë është detyrë e gjykatës ta përcaktojë këtë vlerë “*ex officio*”. Gjithashtu, në LPK nuk është përcaktuar se revizioni nuk është i lejuar në kontestet pa vlerë të përcaktuar.
41. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se LPK-ja përcakton se kontestet lidhur me sendet e paluajtshme nuk janë konteste të vlerës së vogël. Gjykata Supreme nuk e ka marrë parasysh këtë dispozitë në vlerësimin e kontestit të parashtruesit, i cili përfshinte sende të paluajtshme. Më tej, parashtruesit e kërkesës theksojnë se LPK-ja dhe praktika gjyqësore nga Gjykata Supreme e Kroacisë tregojnë se kontestet për paluajtshmëritë janë të përjashtuara nga rregullat për kontestet e vlerës së vogël, po ashtu duke theksuar se neni 486 i LPK-së konfirmon se kontestet me objekt sende të paluajtshme nuk cilësohen si konteste të vlerës së vogël, duke legjitimuar revizionin e parashtruesit për shkak të vlerës së lartë të objektit të kontestit dhe se gjykata është e detyruar të veprojë kur vlera e kontestit nuk është përcaktuar nga palët, sipas nenit 36 të LPK-së.
42. Prandaj, Gjykata, para se të analizojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës, dëshiron të potencojë se ajo në këtë kërkesë nuk do të merret me çështjen e pronësisë ndërmjet parashtruesve të kërkesës dhe të paditurës, dhe as me legjitimitetin juridik të palëve në procedurën e rregullt gjyqësore, por do të fokusohet ekskluzivisht në çështjen e shkeljes së mundshme të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, në kontekstin e shkeljes së të drejtës për qasje në gjykatë, përkatësisht nëse lëshimet procedurale të gjykatave të rregullta rezultuan me situatën që kërkesa e parashtruesve të hidhet poshtë nga Gjykata Supreme për arsye se kjo e fundit, kur vendosi për lejueshmërinë e revizionit, mori një qasje formaliste, duke mos marrë parasysh lëshimet e mundshme procedurale të gjykatave të shkallës më të ulët.
43. Rasti konkret i cili shqyrtohet nga Gjykata lidhet me mënyrën në të cilën kushtet ekzistuese *ratione valoris* kanë vepruar në çështjen e parashtruesve të kërkesës. Konkretisht, rasti ka të bëjë me çështjen nëse Gjykata Supreme, në rrethanat e veçanta të rastit, duke e deklaruar revizionin e parashtruesve të kërkesës të palejuar, ka zbatuar formalizëm të tepruar dhe ka ndikuar në mënyrë joproporcionale në mundësinë e saj për të gjykuar për thelbin e rastit në kontestin e tij pronësor, siç garantohet me rregulloret ligjore. Në kontekst të lartcekurave, Gjykata do të shqyrtojë nëse veprimi i gjykatave të shkallës më të ulët dhe ndërmarrja/mosndërmarrja e veprimeve procedurale nga këto të fundit, kanë rezultuar me kufizimin e qasjes në gjykatën më të lartë.

44. Në zbatimin e kësaj analize, Gjykata fillimisht do t'i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës, si dhe praktikës gjyqësore të GjEDNj-së lidhur me kufizimet e qasjes në gjykatë, duke përfshirë praktikën gjyqësore lidhur me kufizimet e qasjes në gjykatat më të larta. Më pas, do të analizojë praktikën gjyqësore lidhur me çështjen e kufizimit *ratione valoris* të qasjes në gjykatat më të larta, si dhe me çështjet e veçanta të proporcionalitetit që shtrohen në këtë rast, gjegjësisht, kush duhet t'i bartë pasojat e dëmshme të gabimeve të bëra gjatë procedurës, dhe me çështjen e ekzistencës së formalizmit të tepruar.
45. Andaj, Gjykata duhet të përcaktojë nëse lëshimi i Gjykatës Themelore për të vepruar në pajtim me nenin 36 të LPK-së dhe për të përcaktuar vlerën e kontestit rezultoi me situatën ku Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e tij për revizion për arsye tërësisht formale, pa marrë parasysh thelbin e pretendimeve të tij ankimore.
46. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata fillimisht vë në dukje se çështja e refuzimit apo moslejimit të revizionit për shkak se e njëjta nuk e arrin vlerën e përcaktuar me ligj hyn në kuadër të parimit apo të drejtës për qasje në gjykatë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së (shih rastin e Gjykatës [KI96/22](#), parashtrues *Naser Husaj dhe Uliks Husaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 gushtit 2023, paragrafi 49).
47. Thënë këtë, Gjykata i referohet përfundimit të Gjykatës Supreme se revizioni i parashtruesve të kërkesës nuk është i lejuar duke theksuar: *"Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218.1 dhe 2 pika d) të LPK-së, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që të njëjtin t'a hedh si të palejuar."*
48. Duke marrë parasysh sa më sipër, rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me faktin nëse Gjykata Supreme, duke e shpallur *"të palejuar revizionin"* për çështje tërësisht ligjore/procedurale, ka ndikuar në mënyrë joproporcionale në mundësinë e parashtruesve të kërkesës për të marrë një vendim meritator për rastin e tyre nga Gjykata Supreme.
49. Gjykata duke u bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GjEDNj-së në parim ka theksuar e drejta e qasjes në gjykatë duhet të jetë *"praktike dhe efektive"* dhe jo *"teorike dhe iluzore"* (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI20/21](#), parashtruese *Violeta Todorović*, Aktgjykim i 13 prillit 2021, paragrafi 43 dhe [KI224/19](#), parashtrues *Islam Krasniqi*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 39; shih gjithashtu rastin e GjEDNj-së *Famullia Katolike Greke e Lupenit kundër Rumanisë [DHM]*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84). Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GjEDNj-së kjo e drejtë nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve të cilat nuk guxojnë të zvogëlojnë qasjen në gjykatë në atë mënyrë apo deri në një masë që cenojnë vetë thelbin e së drejtës. Kufizimet e tilla nuk do të jenë të arsyetuara nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet përmes tyre (shih, rastet e Gjykatës [KI96/22](#), parashtrues *Naser Husaj dhe Uliks Husaj*, cituar më lart, paragrafi 51; [KI20/21](#), parashtruese *Violeta Todorović*, cituar më lart, paragrafi 45; dhe [KI54/21](#), parashtrues *Kamber Hoxha*, Aktgjykim i 4 nëntorit 2021, paragrafët 63-64; shih, gjithashtu, rastet e GjEDNj-së: *Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë*, nr. 39442/98, Aktgjykim i 16 nëntorit 2000, paragrafi 15; *Bëleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, nr. 47273/99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 61; dhe *Famullia Katolike Greke e Lupenit kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 89).

Parimet e përgjithshme të qasjes në gjykatat më të larta dhe kufizimet racione valoris në këtë aspekt

50. Gjykata, në kontekst të kufizimit të qasjes në gjykata më të larta, përkatësisht në Gjykatën Supreme, e që ndërlidhet me kufizimin *ratione valoris*, i referohet praktikës sa saj gjyqësore, e cila mbështetur në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së ka afirmuar parimet që ndërlidhen me kufizimin *ratione valoris* në Gjykatën Supreme. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se neni 31 i Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNj-së nuk e detyron krijimin e gjykatave të apelit apo supreme, megjithatë në rast se kur ekziston një gjykatë e tillë, duhet të respektohen garancitë e nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNj-së, dhe për rrjedhojë ato duhet t'u garantojnë palëve ndërgjyqëse të drejtën efektive të qasjes në gjykata për të vendosur mbi "*të drejtat dhe detyrimet e tyre civile*" (shih, rastin e Gjykatës KI199/22, parashtrues *P.T.P. "Arta XH"*, Aktgjykim, i 30 korrikut 2024, paragrafi 68; shih gjithashtu rastet e GjEDNj-së, [Andrejeva kundër Letonisë](#), nr. 55707/00, paragrafi 97, shih, gjithashtu [Levages Prestations Services kundër Francës](#), nr. 21920/93, të 23 tetorit 1996, paragrafi 44, dhe [Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës](#), kërkesa nr. 26737/95, të 19 dhjetorit 1997, paragrafi 37).
51. Megjithatë, GjEDNj ka përcaktuar se nuk është detyrë e saj të krijojë qëndrimin e saj nëse politikat e përzgjedhura nga palët kontraktuese, të cilat përcaktojnë kufizimet e qasjes në gjykatë, janë të përshtatshme apo jo; detyra e saj është e kufizuar vetëm në përcaktimin nëse zgjedhjet e tyre në këtë fushë kanë prodhuar pasoja që janë në përputhje me KEDNj. Në mënyrë të ngjashme, roli i Gjykatës nuk është zgjidhja e mosmarrëveshjeve lidhur me interpretimin e ligjit të brendshëm që rregullon këtë qasje, por përcaktimi nëse efektet e një interpretimi të tillë janë në përputhje me KEDNj (shih, rastet e GjEDNj-së, [Platakou kundër Greqisë](#), kërkesa nr. 38460/97, paragrafët 37-39, [Yagtzilar dhe të tjerët kundër Greqisë](#), kërkesa nr. 41727/98, paragrafi 25, dhe [Bulfracht Ltd kundër Kroacisë](#), kërkesa nr. 53261/08, të 21 qershorit 2011, paragrafi 35).
52. Në këtë kuptim duhet ritheksuar se mënyra në të cilën neni 6 paragrafi 1 zbatohet në gjykatat e apelit ose të kasacionit varet nga veçoritë e veçanta të procedurës konkrete dhe se duhet marrë parasysh tërësia e procedurës së ndërmarrë në rendin e brendshëm juridik, si dhe roli i gjykatës së kasacionit në të; kushtet e pranueshmërisë së revizionit mund të jenë më të rrepta se ato për një ankesë së rregullt (shih, rastet e GjEDNj-së [Levages Prestations Services](#), cituar më lart, paragrafi 45; rastin e cituar më lart [Brualla Gómez de la Torre](#), cituar më lart, paragrafi 37; dhe [Kozlica kundër Kroacisë](#), nr. 29182/03, Aktgjykim, i 2 nëntorit 2006, paragrafi 32; shih, gjithashtu rastin [Shamoyan kundër Armenisë](#), nr. 18499/08, Aktgjykim, i 7 korrikut 2015, paragrafi 29).
53. Gjykata bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së theksoi se aplikimi i pragut ligjor *ratione valoris* në lidhje me revizionin në Gjykatën Supreme është një supozim procedural legjitim dhe i arsyeshëm duke pasur parasysh vetë thelbin e rolit të Gjykatës Supreme që ajo të merret vetëm me çështje të rëndësishme të veçantë (shih, rastin e Gjykatës KI199/22, parashtrues *P.T.P. "Arta XH"*, i cituar më lart, paragrafi 71, GjEDNj, [Brualla Gómez de la Torre](#), paragrafi 36; rastin [Kozlica](#), paragrafi 33; rastin e cituar më lart [Bulfracht LTD](#), paragrafi 34, [Dobrić kundër Serbisë](#), kërkesa nr. 2611/07 dhe 15276/07, të 21 qershorit 2011, paragrafi 54; dhe [Jovanović kundër Serbisë](#), kërkesa nr. 32299/08, të 2 tetorit 2012, paragrafi 48).
54. Për më tepër, kur vendosi për çështjet nëse procedurat para gjykatave të apelit ose të kasacionit janë në përputhje me kërkesat e paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNj-së, Gjykata mori parasysh shkallën në të cilën çështja ishte shqyrtuar para gjykatave më të ulëta, (mos)ekzistencën e çështjeve që lidhen me drejtësinë e procedurave të zhvilluara para

- gjykatave më të ulëta, si dhe natyrën e rolit të gjykatës në fjalë (shih, rastet e GjEDNj-së, [Levages Prestations Services](#), paragrafët 45-49; rastin e cituar më lart [Brualla Gómez de la Torre](#), paragrafët 37-39; [Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë](#), nr. 39442/98, paragrafi 22; dhe [Nakov kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#) (Vendim) nr. 68286/01, Vendim, i 24 tetorit 2002).
55. Thënë këtë, Gjykata i referohet rastit të Dhomës së Madhe të GjEDNj-së në rastin [Zubac kundër Kroacisë](#) [nr. 40160/12, Aktgjykim i 5 prillit 2018], si dhe rasteve të praktikës së vet gjyqësore, përmes së cilës në lidhje me çështjen e lejueshmërisë së revizionit e që ndërlidhet me prapësinë e vlerës së përcaktuar me ligj, në parim kishte ritheksuar se: “Mënyra se si zbatohet neni 6 paragrafi 1 [të KEDNj-së] në gjykatat e apelit dhe të kasacionit varet nga veçoritë e veçanta të procedurës para atyre gjykatave. Kushtet e pranueshmërisë së revizionit mund të jenë më të rrepta se ato për një ankesë të rregullt” (shih paragrafin 82 të Aktgjykimit dhe referencat e përdorura aty, siç është rasti [Kozlica kundër Kroacisë](#), nr. 29182/03, Aktgjykim i 2 nëntorit 2006, paragrafi 32). Në vijim të kësaj, GjEDNj po në të njëjtin rast kishte theksuar se: “Aplikimi i pragut ligjor *ratione valoris* për revizionin në Gjykatën Supreme është supozim procedural legjitim dhe i arsyeshem duke pasur parasysh se gjykata merret vetëm me çështje të rëndësishme të veçanta (shih paragrafin 83 të Aktgjykimit në rastin [Zubac kundër Kroacisë](#) dhe referencat e përdorura në këtë rast, ndër tjerash, shih edhe rastin [Jovanović kundër Serbisë](#), nr. 32299/08, Aktgjykim i 2 tetorit 2012, paragrafi 48; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI96/22](#), parashtrues [Naser Husaj dhe Uliks Husaj](#), cituar më lart, paragrafi 52, [KI199/22](#), parashtrues: *P.T.P. “Arta XH”*, i cituar më lart, [KI04/23](#)).
56. Në këtë kuptim, GjEDNj po në rastin [Zubac kundër Kroacisë](#), dhe në lidhje me zbatimin e kufizimeve ligjore *ratione valoris* për qasje në gjykatat më të larta, zhvilloi një test tre hapësh, përmes të cilit duhet të shqyrtohen dhe vlerësohen: (i) parashikueshmëria e kufizimeve; (ii) çështja nëse parashtruesi apo shteti duhet t’i bartë pasojat e dëmshme të gabimeve të kryera gjatë procedurës; dhe (iii) çështja e “formalizmit të tepërt” në zbatimin e kufizimeve (shih paragrafët 80-86 të Aktgjykimit në rastin [Zubac kundër Kroacisë](#), dhe referencat e përdorura në këtë Aktgjykim) të njëjtat parime, u afirmuan dhe janë aplikuar edhe përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës (shih, rastet e Gjykatës [KI96/22](#), parashtrues [Naser Husaj dhe Uliks Husaj](#), cituar më lart, paragrafi 53; [KI199/22](#), parashtrues: *P.T.P. “Arta XH”*, i cituar më lart, paragrafi 74).
57. Në lidhje me të parën, GjEDNj specifikoi se (i) çështja e mjetit ligjor në këtë rast ishte e parashikueshme nga këndvështrimi i palëve ndërgjyqësore. Në këtë kuptim, GjEDNj shtoi se (ii) supozimi se kufizimi i qasjes është i parashikueshem plotësohet nëse ka praktikë koherente gjyqësore dhe (iii) zbatim konsistent të kësaj praktike, dhe në vijim po ashtu vlerësoi se (iv) merr parasysh qasjen e parashtruesit në praktikën përkatëse gjyqësore dhe (v) nëse i njëjti përfaqësohet nga një avokat i kualifikuar (shih, paragrafët 87-89 të Aktgjykimit në rastin [Zubac kundër Kroacisë](#); shih, po ashtu, rastet e Gjykatës [KI96/22](#), parashtrues [Naser Husaj dhe Uliks Husaj](#), cituar më lart, paragrafi 54; dhe [KI199/22](#), parashtrues: *P.T.P. “Arta XH”*, i cituar më lart, paragrafi 75).
58. Në lidhje me atë nëse parashtruesi apo autoritete publike duhet të bartin pasojat e dëmshme të lëshimeve të kryera gjatë procedurës, Gjykata duke aplikuar kriteret e përcaktuara në rastin [Zubac kundër Kroacisë](#), theksoi se duhet të përcaktohet nëse parashtruesit e kërkesës ka qenë i përfaqësuar gjatë procedurave, si dhe nëse ai ka treguar zellin e duhur në ndërmarrjen e veprimeve përkatëse procedurale, duke vijuar me përcaktimin e çështjes nëse gabimet mund të ishin shmangur që në fillim dhe nëse gabimet mund t’i atribuohen kryesisht parashtruesit apo autoriteteve kompetente (shih, paragrafët 90-95 të Aktgjykimit të GjEDNj-së në rastin [Zubac kundër Kroacisë](#); si dhe shih rastet e Gjykatës [KI96/22](#), parashtrues [Naser Husaj dhe Uliks Husaj](#), cituar

më lart, paragrafi 55; [KI199/22](#), parashtrues: P.T.P. "Arta XH", i cituar më lart, paragrafi 76).

59. Në lidhje me të tretën, përkatësisht me çështjen e formalizmit të tepruar, Gjykata bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka ritheksuar se formalizmi i tepruar nga ana e gjykatave mund të jetë në kundërshtim me të drejtën për qasje në gjykatë. Në këtë kuptim, GJEDNJ kishte theksuar se, "megjithatë, e drejta për qasje në gjykatë konsiderohet se është dëmtuar në atë moment kur rregullat pushojnë të jenë në shërbim të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë dhe për pasojë krijojnë një barrierë e cila i pamundëson palëve ndërgjyqëse që rasti i tyre të gjykohet në merita nga gjykata kompetente" (shih paragrafin 98 të Aktgjykimit në rastin [Zubac kundër Kroacisë](#); dhe shih rastet e Gjykatës [KI96/22](#), parashtrues Naser Husaj dhe Uliks Husaj, cituar më lart, paragrafi 56; [KI199/22](#), i cituar më lart, paragrafi 102).
60. Gjykata ka afirmuar se kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme duke vendosur një prag ligjor *ratione valoris* justifikohet nga qëllimi legjitim i Gjykatës Supreme që të merret vetëm me çështje të rëndësishme. Sipas saj, zgjidhja e parregullsive të kryera nga gjykatat më të ulëta në përcaktimin e vlerës së objektit të kontestit, synonte gjithashtu një qëllim legjitim, përkatësisht respektimin e sundimit të ligjit dhe funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor (shih rastet e Gjykatës [KI96/22](#), parashtrues Naser Husaj dhe Uliks Husaj, cituar më lart, paragrafi 57; [KI199/22](#), i cituar më lart, paragrafi 78; shih në këtë kontekst specifik paragrafët 101-125 të Aktgjykimit në rastin e GJEDNJ-së [Zubac kundër Kroacisë](#)).
61. Gjykata konsideron se në rrethana të tilla, gjykatat e rregullta gëzojnë një liri të gjerë të vlerësimit të mënyrës së zbatimit të kufizimeve përkatëse *ratione valoris* në këtë rast. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se gjykatat gëzojnë diskrecion të pakufizuar në këtë kuptim. Me rastin e shqyrtimit nëse kjo liri e vlerësimit është tejkaluar, Gjykata duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë tre kritereve, përkatësisht (i) parashikueshmërisë së procedurës e cila zbatohet në lidhje me revizionin; (ii) çështjes së kush duhet t'i bartë pasojat e dëmshme të gabimeve të bëra gjatë procedurës, dhe (iii) çështjes nëse qasja e parashtruesve të kërkesës në Gjykatën Supreme është kufizuar nga formalizmi i tepruar (shih, rastin e Gjykatës, [KI199/22](#), i cituar më lart, paragrafi 78).
62. Prandaj, Gjykata në vijim do të zbatojë parimet dhe testin e lartcekur të zhvilluar nga GJEDNJ në rrethanat e rastit konkret, përkatësisht ajo (i) në lidhje me kriterin e parashikueshmërisë së kufizimit përmes pragut ligjor, do të vlerësojë nëse praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme është konsistente dhe e qartë në lidhje me lejueshmërinë e revizionit; pastaj (ii) do të vlerësojë nëse kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme mund t'i atribuohet gabimit të parashtruesve të kërkesës; si dhe (iii) do të vlerësojë nëse Gjykata Supreme gjatë interpretimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi që ndërlidheshin me prapun e lejueshmërisë së revizionit kishte zbatuar formalizëm të tepruar.
- (i) *Parashikueshmëria e procedurës e cila zbatohet në lidhje me revizionin*
63. Duke iu rikthyer rrethanave të rastit konkret, lidhur me (i) çështjen e parashikueshmërisë së kufizimit, Gjykata, së pari, do të vlerësojë me kujdes mënyrën se si Gjykata Supreme e shqyrtoi revizionin e parashtruesve të kërkesës për të përcaktuar nëse Gjykata Supreme ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore në lidhje me prapun ligjor për lejueshmërinë e revizionit. Në mbështetje të kësaj, Gjykata vëren se në rendin juridik, qasja në Gjykatën Supreme në çështjet civile sigurohet përmes revizionit në bazë të nenit 211 të LPK-së. Revizioni i referohet kontesteve në të cilat pjesa e goditur e aktgjykimit tejkalon një prag të caktuar të vlerës. Atëherë kur arrihet ky prag i vlerës, qasja në Gjykatën Supreme bëhet çështje e së drejtës individuale. Në kuadër të

revizionit, Gjykata Supreme mund të anulojë aktgjykimet e gjykatave më të ulëta dhe të kthejë rastin në rigjykim ose, në raste të caktuara, të ndryshojë aktgjykimin e kontestuar. Në çdo rast, Gjykata Supreme është e autorizuar të shpallë të palejuar çdo revizion i cili nuk i përmbush kushtet përkatëse ligjore.

64. Në këtë rast, parashtruesit e kërkesës parashtruan revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Më tej, Gjykata Supreme e hodhi poshtë si të palejuar revizionin e paraqitur nga parashtruesit e kërkesës, duke arritur në përfundimin se vlera përkatëse e objektit të kontestit është nën minimumin ligjor. Gjatë vlerësimit të pranueshmërisë *ratione valoris*, Gjykata Supreme theksoi: "[...] në këtë çështje juridike kontestimore fillimisht vlerësoi lejueshmërisë e revizionit bazuar në nenin 211.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ku është përcaktuar se: "Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpapia nuk ka të bëjë me kërkesa në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë prestimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk kalon shumën prej 3,000 €". Ndërsa me nenin 30 paragrafi 1 të LPK-se, përcaktohet se: "Paditësi ka për detyrë që në kontestet pasurore - juridike, në padi të përcaktoj vlerën e objektit të kontestit. Si vlerë e objektit të kontestit merret parasysht vetëm vlera e kërkesës kryesore", ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: "Kamatat, shpenzimet e procedurës, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera aksesore, nuk merren parasysht në qoftë se nuk përbejnë kërkesë kryesore".

Në këtë rast palët paditëse me padi e as me precizimin e me vonshëm të kërkesës nuk kanë përcaktuar vlerën e kontestit, ndërsa gjykata me vërejtjen gjyqësore të datës 09.03.2017 ka ftuar palën paditëse që në emër të taksës gjyqësore për padi të paguaj taksën në lartësi prej 15 € të cilën e ka paguar pala paditëse. Gjykata Supreme është e obliguar që të vlerësoj lejueshmërinë e revizionit dhe në këtë rast revizioni nuk është i lejuar për shkak të vlerës së kontestit, marrë për bazë faktin që paditësit nuk kanë cekur vlerën e kontestit në padi dhe precizimin e mëvonshëm të kërkesës, kurse taksa e paguar për padi nuk e tejkalon vlerën e kontestit mbi 3.000 € sipas udhëzimit administrativ për unifikimet e taksave gjyqësore si dhe natyra e kontestit nuk përbën përjashtim për lejueshmërinë e revizionit (përjashtimet pavarësisht vlerës).".

65. Bazuar në një konkluzion të tillë të Gjykatës Supreme është më se e qartë se Gjykata Supreme me rastin e vendosjes në lidhje me revizionin ka refuzuar kërkesën për revizion në bazë të dispozitave ligjore të paragrafit 3 të nenit 211 të LPK-së, duke mos hyrë në thelbin e pretendimeve ankimore të parashtruesve të kërkesës.
66. Prandaj, përkundër shpjegimit të qartë në kërkesën për revizion është më se evidente se Gjykata Supreme ka vepruar plotësisht në përputhje me dispozitën ligjore të nenit 30 dhe paragrafin 3 të nenit 221 të LPK-së, të cilat në mënyrë konkrete përcaktojnë kufizimet ligjore të shqyrtimit të revizionit, nëse se vlera e kontestit nuk është përcaktuar fare nga parashtruesit e kërkesës.
67. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se dispozitat ligjore të referuara nga Gjykata Supreme sigurisht përmbajnë kufizime në lidhje me aprovimin e revizionit në kuptimin formal dhe si i tillë, ai është i qartë dhe i parashikueshëm si për parashtruesit e kërkesës ashtu edhe për Gjykatën. Mirëpo, parashikueshmëria e kufizimeve ligjore dhe zbatimi i tyre varen sipas rastit, dhe ato, si të tilla, duhet të jenë objekt i një vlerësimi gjithëpërfshirës, ku në vlerësimin e tyre duhet shmangur qasja formaliste kur kufizimet zbatohen në një rast konkret.

(ii) Çështja se kush duhet t'i bartë pasojat e dëmshme të gabimeve të kryera gjatë procedurës

68. Duke shqyrtuar me kujdes kushtin e dytë (ii) nëse kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme mund t'i atribuohet gabimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata, për të arritur një përgjigje, duhet të ketë parasysh vetë fillimin e paraqitjes së kërkesëpadsisë si dhe dispozitat ligjore të LPK-së, të cilat rregullojnë çështjen dhe procedurën e përcaktimit të vlerës së kontestit me rastin e paraqitjes së kërkesëpadsisë.
69. Pikërisht në mbështetje të kësaj, Gjykata rikujton se kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme mbulohet nga qëllimi legjitim i pranuar përgjithësisht i pragut ligjor *ratione valoris* për ankesat në Gjykatën Supreme, qëllimi i të cilit është të sigurojë se Gjykata Supreme, duke pasur parasysh vetë thelbin e rolit të saj, të merret vetëm me çështjet me rëndësi. Në mbështetje të kësaj, Gjykata rikujton se roli i Gjykatës Supreme, ndër të tjera, është të sigurojë zbatim unik të ligjit, si dhe barazinë e të gjithëve në zbatimin e tij. Duke pasur parasysh këtë funksion, Gjykata e sheh të nevojshme të vlerësojë nëse vendimi i Gjykatës Supreme ndjek një qëllim legjitim, përkatësisht respektimin e sundimit të ligjit dhe funksionimin e duhur të sistemit të drejtësisë (shih, rastin e sipërpërmendur të Gjykatës: [KI199/22](#)).
70. Lidhur me këtë, Gjykata do të shqyrtojë me kujdes shkallën në të cilën rasti i parashtruesve të kërkesës është adresuar para gjykatave më të ulëta, më konkretisht sa është adresuar kërkesa e tij për përcaktimin e vlerës së kontestit, si dhe natyrën e rolit të Gjykatës Supreme.
71. Prandaj, për Gjykatën nuk është kontestues fakti se parashtruesit e kërkesës kanë paraqitur padi në Gjykatën Themelore pa specifikuar vlerën e kërkesëpadsisë, edhe pse paragrafi 1 i nenit 30 i LPK-së thotë se *“Paditësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padi të përcaktojë vlerën e objektit të kontestit [...]”*.
72. Megjithatë, duke shqyrtuar me kujdes dispozitën e nenit 36 të LPK-së, Gjykata gjithashtu vëren se në qoftë se paditësi nuk vepron në përpunje me nenin 30 të LPK-së dhe nuk përcakton vlerën e objektit të kontestit në kërkesëpadinë, ai nuk do t'i bartë pasojat procedurale për arsye se pikërisht me nenin 36 të LPK-së bëhet një përjashtim, në atë mënyrë që detyrimi për të përcaktuar vlerën e kontestit si veprim procedural kalon mbi gjykatën. Më konkretisht, *“[...] gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike, por para se të filloj shqyrtimi i çështjes kryesore, shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktoj, përkatësisht do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi. Në rast të këtyllë gjykata vendosë me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankimi”*.
73. Rrjedhimisht, nga teksti i dispozitës ligjore të nenit 36 të LPK-së shihet qartë se vlera e objektit të kontestit është një nga elementet e padsisë, element i cili është i përcaktuar me ligj, por nuk është parakusht i domosdoshëm për ngritjen e padsisë. Prandaj, edhe në rastet kur pala nuk e ka përcaktuar vlerën e objektit të kontestit në momentin e paraqitjes së kërkesëpadsisë, gjykata nuk do ta refuzojë padinë dhe as nuk do t'ia kthejë padinë paditësit për korrigjim.
74. Me fjalë të tjera, në rastet kur paditësi nuk e ka caktuar vlerën e objektit të kontestit ose në qoftë se e ka caktuar vlerën e tij shumë të vogël ose tepër të lartë, gjykata sipas detyrës zyrtare apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse seanca përgatitore nuk është mbajtur, atëherë para fillimit të shqyrtimit kryesor përshtatshëmrisht cakton vlerën e objektit të kontestit, duke marrë parasysh rrethanat objektive të kërkesëpadsisë në fjalë.

75. Gjykata gjen se dispozita ligjore e nenit 36 të LPK-së është mjaft e qartë, si në aspektin e të drejtave ashtu edhe në aspektin e veprimeve dhe detyrimeve procedurale, dhe përcakton qartë se Gjykata Themelore ka detyrimin që sipas detyrës zyrtare të caktojë vlerën e kontestit në 3 situata të ndryshme, dhe ato janë: *(i) kur paditësi nuk e ka caktuar vlerën e kontestit, (ii) kur paditësi e ka caktuar vlerën shumë të vogël të kontestit; dhe (iii) kur paditësi e ka caktuar vlerën tepër të lartë të kontestit.* Për më tepër, detyrimi i Gjykatës Themelore, kur paraqitet një kërkesëpadi nga neni 36 i LPK-së, është të caktojë vlerën e objektit të kontestit sipas detyrës zyrtare dhe atë me aktvendim para fillimit të seancës së shqyrtimit kryesor. Prandaj, parakushti që gjykata të mund të veprojë sipas kërkesëpadi në merita është që fillimisht të caktojë vlerën e kontestit në fjalë përmes një aktvendimi të veçantë në një seancë të posaçme.
76. Për sa i përket mënyrës së përcaktimit dhe verifikimit të vlerës së objektit të kontestit, gjykata është e detyruar që sipas kriterëve objektive të përcaktojë ekuivalentin monetar të kërkesëpadi në bazë të të dhënave nga padia dhe vetëm nëse kjo është e mundur për nga natyra e çështjes, gjegjësisht të përcaktojë paraprakisht vlerën e objektit të kontestit, përkatësisht nëse vlera e objektit të kontestit është shënuar dhe nëse ajo është shënuar si tepër e lartë apo shumë e ulët. Ky verifikim zbatohet deri në kufirin e probabilitetit të pranueshëm, sepse çdo shqyrtim më i thellë i problemit, përkatësisht kërkesëpadi, do të rrezikonte realizimin e detyrës themelore të gjykatës, që është sigurimi i mbrojtjes juridike.
77. Prandaj, vetë fakti se parashtruesit e kërkesës nuk e kishin përcaktuar vlerën e kontestit para Gjykatës Themelore e kualifikon kërkesëpadinë e tij si kërkesëpadinë e kategorisë *i) kur paditësi nuk e ka përcaktuar vlerën e kontestit* nga neni 36 i LPK-së, sipas së cilës kishte iniciuar procedurën në të cilën Gjykata Themelore ka për obligim të merret me këtë kërkesë sipas detyrës zyrtare.
78. Gjykata nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore konstaton se kjo e fundit nuk ka vepruar në pajtim me në mënyrën e kërkuar nga neni 36 i LPK-së. Gjykata duhet të theksojë se lëshimi i gjykatës për të vepruar në cilëndo pjesë të procedurës mund të krijojë pasoja negative për parashtruesit e kërkesës dhe për këtë arsye këto lëshime nuk mund të përcaktohen si lëshime të paditësit.
79. Më konkretisht, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës gjatë procedurës së paraqitjes së kërkesëpadi, në pajtim me nenin 30 të LPK-së në lidhje me nenin 36 të LPK-së, nuk kanë bërë gabime lidhur me përcaktimin e vlerës së objektit të kontestit, dhe rrjedhimisht, gabimet, nëse kanë ndodhur para Gjykatës Themelore, sipas mendimit të kësaj Gjykate, nuk mund t'i atribuohen objektivisht parashtruesve të kërkesës.
80. Për më tepër, sipas mendimit të Gjykatës, asnjë pritje e arsyeshme nuk mund të lindë nga lëshimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit në këtë rast. Gjithashtu, as fakti se parashtruesit e kërkesës kanë paguar taksën në shumë prej 15 € me rastin e paraqitjes së kërkesëpadi në Gjykatën Themelore, nuk mund t'i atribuohet si gabim i tij dhe të jetë fakt përcaktues që mund të përdoret gjatë caktimit të vlerës së objektit të kontestit, për arsye se për Gjykatën nuk është fakt kontestues se parashtruesit e kërkesës me rastin e paraqitjes së kërkesëpadi në pajtim me vlerën e objektit të kontestit, duhet të paguajnë edhe taksën gjyqësore të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në thelb, pagesa e taksës në shumë prej 15 € nuk mund të shërbejë si parametër i vetëm për caktimin e vlerës së kontestit në fjalë, sidomos për arsye se parashtruesit e kërkesës kanë paguar taksën gjyqësore në vlerë prej 15 € si një shumë të kushtëzuar që pala është e detyruar të paguajë kur nuk dihet vlera e kontestit, ndërsa vetë taksa në shumë prej 15 € është kusht i cili i mundëson palës që kërkesëpadija e saj të pranohet nga gjykata në kuptimin procedural, dhe jo të hidhet poshtë si një kërkesëpadi e paplotë para fillimit të procedurës.

81. Në mbështetje të kësaj, Gjykata dëshiron të shtojë se, në qoftë se Gjykata Themelore nuk do të kishte bërë lëshimin (gabimin) procedural në procedurën për përcaktimin e vlerës së kontestit dhe në qoftë se vlera do të ishte përcaktuar nga Gjykata Themelore siç kërkohet nga neni 36 i LPK-së, do të ishte krijuar një situatë që do t'i mundësonte parashtruesve të kërkesës pagesën e shumës shtesë (diferencës) të vlerës së taksës gjyqësore për vlerën e caktuar të kontestit në mënyrë që të arrihet shuma e nevojshme e vlerës së përcaktuar të kontestit.
82. Gjykata është e mendimit se gabimet në procedurë mund të ishin evituar që në fillim, në qoftë se Gjykata Themelore do të kishte vepruar në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 36 të LPK-së. Nga kjo rezulton se këto gabime mund t'i atribuohen objektivisht gjykatave, dhe jo parashtruesve të kërkesës.
- (iii) *Nëse Gjykata Supreme ka përdorur formalizëm të tepruar gjatë interpretimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi lidhur me pragun e lejueshmërisë së revizionit*
83. Për sa i përket vlerësimit të përmbushjes së kriterit të tretë, Gjykata thekson se respektimi i rregullave formale të procedurës kontestimore, përmes së cilës palët sigurojnë vendimmarrjen për kontestin civil, është i vlefshëm dhe i rëndësishëm sepse kështu mund të kufizohet liria diskrecionale, të sigurohet barazia e armeve, të parandalohet arbitrariteti dhe të sigurohen efektiviteti gjatë vendimmarrjes për kontestin dhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, si dhe siguria juridike dhe respektimi i gjykatës.
84. Megjithatë, në praktikën gjyqësore të Gjykatës është përcaktuar se “formalizmi i tepruar” mund të jetë në kundërshtim me kërkesën për të siguruar të drejtën praktike dhe efektive për qasje në gjykatë bazuar në nenin 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNj-së. Kjo zakonisht ndodh në rastet e një interpretimi të rreptë të një rregulli procedural që pengon shqyrtimin e meritave të padisë së parashtruesit të kërkesës, me rrezikun përkatës se do të cenohet e drejta e tij apo e saj për mbrojtje efikase gjyqësore (shih, ndër tjerash rastin e Gjykatës [KI199/22](#), parashtrues: *P.T.P. “Arta XH”*, i cituar më lart, paragrafi 100, bazuar në rastet e GjEDNj-së [Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), kërkesa nr. 47273/99, paragrafët 50-51 dhe 69, dhe [Walchli kundër Francës](#), kërkesa nr. 35787/03, paragrafi 29).
85. Prandaj, në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk do duhej të ishte e lidhur nga gabimet e gjykatave më të ulëta gjatë vendosjes nëse do t'i mundësojë qasjen parashtruesve të kërkesës, por duhet të kishte shqyrtuar nëse qasja tek ajo ishte pamundësuar nga lëshimet procedurale të gjykatave të shkallës më të ulët.
86. Lidhur me këtë, mund të thuhet se thirrja e Gjykatës Supreme vetëm në dispozitën ligjore të paragrafit 3 të nenit 211 të LPK-së dhe dhënia e arsytimit pa shqyrtimin paraprak të lëshimit të mundshëm procedural, se “*Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadija nuk ka të bëjë me kërkesa në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë prestimi tjetër, po qe se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk kalon shumë prej 3.000 €*”, duke e kaluar përgjegjësinë dhe gabimin vetëm mbi parashtruesit e kërkesës dhe duke e arsytuar këtë me faktin se në bazë të nenit 30 paragrafi 1 të LPK-së është përcaktuar se: “*revizioni është i palejuar, paditësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padi të përcaktoj vlerën e objektit të kontestit...*”, sipas konkluzionit të Gjykatës, përbën formalizëm të tepruar në interpretimin e rregulloreve ligjore, sidomos për arsye se Gjykata Supreme nuk ka marrë parasysh nenin 36 të LPK-së dhe, në qoftë se do të kishte bërë këtë dhe sikur të kishte shqyrtuar dispozitën në rrethanat e rastit konkret,

ajo mund të kishte arritur në përfundimin e saj për lëshimet ose gabimet e mundshme të kryera në radhë të parë nga Gjykata Themelore, e në procedurën e mëtejshme edhe nga Gjykata e Apelit.

87. Po ashtu, sipas nenit 486 të LPK-së, vërehet se nuk konsiderohen konteste të vlerës së vogël, kontestet lidhur me sendet e paluajtshme, kontestet nga marrëdhëniet e punës dhe kontestet për shkak të pengimit të posedimit. Pra, LPK-ja në mënyrë të qartë përcakton se kontestet lidhur me sendet e paluajtshme nuk konsiderohen si konteste të vlerës së vogël. Megjithatë, Gjykata Supreme nuk i është referuar kësaj dispozite kur ka vlerësuar vlerën e kontestit të parashtruesve të kërkesës, i cili në fakt lidhej me sende të paluajtshme.
88. Në këto rrethana, duke marrë parasysh se për rastin e parashtruesve të kërkesës kanë vendosur dy instanca të gjykatave të rregullta, ajo Themelore dhe e Apelit, të cilat kishin juridiksion të plotë në këtë rast, për ta përcaktuar vlerën e kontestit *ex officio* dhe se roli i Gjykatës Supreme është edhe rishikimi i zbatimit të ligjit në fuqi nga gjykatat e shkallës më të ulët, mund të thuhet se vendimi i Gjykatës Supreme në rastin konkret përbënte një pengesë joproporcionale që cenon vetë thelbin e të drejtës së parashtruesve të kërkesës, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së dhe se e njëjta ka tejkaluar lirinë e vlerësimit.
89. Thënë këtë, Gjykata konsideron se konstatimi i shkeljes së paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret ndërlidhet vetëm me parimin e qasjes në gjykatë, përkatësisht në Gjykatën Supreme dhe në asnjë mënyrë nuk e paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 113 dhe nenin 116 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, më 24 shtator 2024, njëzëri,

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktvendimin [Rev. nr. 382/2023] të 17 tetorit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës;
- IV. TË KTHEJË Aktvendimin [Rev. nr. 382/2023] të 17 tetorit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës rivendosje në pajtim me konstatimet e Gjykatës në këtë Aktgjykim;
- V. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me paragrafin (5) të rregullit 60 të Rregullores së punës, deri më 24 Mars 2025, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;
- VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- VII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani